



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 315 Prot.

Tiranë, më 01.03.2018

**VENDIM Nr. 35, datë 21.02.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Pikë karburanti dhe kompleks shërbimesh 2 katëshe" në fshatin Toç, Memaliaj*-subjekti Z.Visi Çausi, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji " K.A.E.XH." sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Pikë karburanti dhe kompleks shërbimesh 2 katëshe" në fshatin Toç, Memaliaj*-subjekti Z.Visi Çausi, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji " K.A.E.XH." sh.p.k.
2. Subjekti Z.Visi Çausi, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Pikë karburanti dhe kompleks shërbimesh 2 katëshe" në fshatin Toç, Memaliaj, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTRE**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**